



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr.02-060/03-55880 dt. 20/11/2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Bekim Lestrani, më datë: **29.11.2024** (E premtë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS


Mbledhja do të ketë këtë:


Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 31.10.2024
2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për transfer të mjeteve financiare subvencione dhe transfere me nr. 02-400/01-47954 dt. 30.09.2024.
3. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt.19.09.2024.
4. Të ndryshme.

Drenas, 20.11.2024

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Bekim Lestrani





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060104-5580 dt. 20/11/2024

PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 31.10.2024 e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi
Dhe i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK), Kosovare Halilaj Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). Munguan Kosovare Halilaj Karaxha, Fatmir Baliu, Mergim Pirraku

Të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, zyra e informimit, .
Prezent ishin 28 anëtar të Kuvendit Komunal
Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

Rend dite

1. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 19.09.2024
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.09.2024.
3. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit
4. Draft Propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029.
5. Raporti Financiar Janar- Shtator 2024.
6. Raport për implementimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin Fiskal 2023.
7. Propozim vendim për Plotësim-ndryshimin e vendimit nr. 02-400/01-45467 të dt. 13.09.2024 për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.
8. - Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 12/030-65509 i dt. 23.12.2021, u tërheq nga rendi i ditës.
9. Propozim Vendim për plotësim/ndryshimin e Komitetit për Komunitete nr.12-030/01-65508 i dt.23.12.2021 i plotësuar me vendimin nr.02-030/01-14938 të dt.28.03.2023

10. Vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit nr.02-020/04-14930 i dt.28.03.2023

11. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, përshëndetje për të gjithë, a ka dikush për diskutim po Florentina.

Florentina Elezi, kisha propozuar që me hyre në rende të ditës edhe plotësimi me anëtarë të cilët mungojnë dy komitete, Komiteti Për politik dhe financa dhe Komiteti për komunitete i cili nuk ka mbajtur mbledhje për një kohe të gjatë për shkak që nuk është zëvendësuar anëtari që ka qenë edhe kryesues.

Beqir Kiqina, edhe me shtuar të të ndryshmet që me u bëre plotësim - ndryshimi i komisionit për emërimin dhe riemërimin e rrugëve, pasi që ky komision nëse nuk gaboj i duhet një anëtarë shtesë për arsye së ka dhënë dorëheqje dikush dhe ky komision mbetur mbrapa. Faleminderit.

Ramiz Lladrovci Kryetar i Komunës së Drenasit, nuk i dëgjova mire propozimet d.m.th ke kërkuar me u tërhequr dhe me e zëvendësuar një Beqa tha me e plotësuar edhe një të komisioni për emërimin e rrugëve shesheve. Normal të ndryshmet siç ju kam deklaruar edhe në mbledhjen e kaluar edhe në komitet, sigurisht që të debatojmë do të diskutojmë edhe për kërkesat e të interesuarve për pronat, për dhënie e pronave në shfrytëzim me negociim, dhe të ndryshmet ndërrohet komiteti ,ligji e thotë kush ka me qenë anëtar i kujt, zëvendësimi behët e propozoni emrin edhe në rregull jemi me futet si pikë e rendit të ditës pra po shtohen tri pika.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, rendit të ditës i shtohen edhe tri pika të reja

Propozim Vendim për plotësim/ndryshimin e Komitetit për Komunitete nr.12-030/01-65508 i dt.23.12.2021 i plotësuar me vendimin nr .02-030/01-14938 të dt.28.03.2023.

Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 12/030-65509 i dt. 23.12.2021 u Terhjek nga rendi i ditës.

Propozim Vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit nr.02-020/04-14930 i dt.28.03.2023

Mehdin Salihu- edhe DD duhet të ketë anëtarin në komitetin për politik e financa se ja lejon rregullorja po pasi na është dhënë rasti kësaj radhe edhe ne dëshirojmë të plotësojmë .

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci- vetëm për plotësim, anëtarin e keni ju në qoftëse keni vota me e largu, me e propozua tjetër kënd keni të drejt me propozuar nëse i keni votat.

Mehdin Salihu-rregullorja e lejon që DD ti ketë dy anëtar një anëtar i DD-së vullnetarisht u largu prej subjekti tonë dhe praktikisht ne komitet ai nuk na përfaqëson neve .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, i nderuar sipas ligjit për zgjedhje anëtarët që janë të zgjedhur nga grupet e caktuara politike nuk mund të ndryshohen gjate mandatit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës me tri pikat shitesë . Për votuan 28 , Abstenim 0 , Kundër 0

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 1.Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 19.09.2024

Pasi nuk pati diskutime ,vërejte, sugjerime pika 1.Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 19.09.2024

Për votuan 28 , Abstenim 0 , Kundër 0

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 2.Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.09.2024.

Pasi nuk pati diskutime ,vërejtjeje, sugjerime pika 2.Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.09.2024. kalon në mënyrë unanime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3.Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.

Florentina Elezi, ne si vetëvendosje kishim propozuar që të formohet një komision nga kuvendi komunal për me monitoruar procesin e zgjedhjes se drejtoreve.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, të nderuar anëtar të kuvendit rregullorja e përcakton përbërjen e komisionit, ne jemi bazuar ne këtë rregullore dhe kemi ardhur me këtë propozim vendim që të marrim miratimin e kuvendit, Florentina po thotë me caktuar një komision nuk e di sa ka bazë ligjore një komision me monitoruar një komision.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, jo me monitoruar për zgjedhjen e drejtorëve por me monitorua çdo konkurs jeni të lira, unë i kom ftuar krejt mediat OJQ-të, me ardhur me i përcjell me i monitoruar, komision mbi komision nuk mundemi me bërë, sepse komisioni, komisionin nuk mundet me e monitoruar nuk ka rregulla.

Mehdin Salihu, unë nuk po e kuptoi çka po doni me formuar a mundeni këtë me na sqaruar, këtë komision që keni me e formuar prej sa anëtarëve përbëhet asnjë informacion nuk e keni.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, i nderuar komisioni përbehet prej tre anëtarëve një anëtar shkon në bazë të rregullores nr19/2024 për zgjedhjen e drejtoreve një anëtar, shkon nga drejtorja komunale e arsimit ku në këtë rast e kemi propozuar Arbesa Dobra dhe një anëtar nga këshilli i prindërve e kemi propozuar kryetarin e këshillit të prindërve Arben Haziri dhe një anëtar nga ministria e arsimit ku në këtë rast është në diskrecion

Të ministrisë se arsimit dhe ne nuk e dijm kush është pasi të formohet komisioni dhe kur ne të fillojmë procedurën ata e dërgojnë anëtarin nga ministria e arsimit ne llogaritëm që ju e keni marr materialin dhe i dini emrat e anëtarëve të komisionit.

Hamit Haxhiu-është shumë e vërtet që materialin e kemi marrë para komitetit edhe DD e ka anëtarin e komitetit për politik e financa që është dashtë me ia pasqyruar rendin e ditës edhe normal që ky material u ardh edhe me herët nuk ka arsye me thënë se ne nuk jemi të informuar për këtë komision .

Egzona Terdevci- një koleg po thotë që përfaqësuesi i këshillit të prindërve është drejtor në një shkollë nuk e kam të konfirmuar si informatë po drejtori ndoshta mundet me na tregu se nëse është e vërtet nuk ka kuptim ai me qenë pjesë e komisionit.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, Arben Haziri është kryetar i këshillit të prindërve jemi në procedurë të ndryshimit sepse është ushtrues detyre për momentin në shkollën në Krajkovë, deri sa e mbanë pozitën si kryetar i këshillit të prindërve atëherë jemi të obliguar ,dhe njëkohësisht në momentin që ndërrohet vazhdojmë me kryetarin e ri.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, propozojë t'i një emër prej këshillit të prindërve kënd të duash të bëjmë nuk e kemi asnjë lloje problemi vetëm duhet me u pajtohet këshilli i prindërve, kënde duash ta bëjmë nuk e kemi asnjë lloj problemi vetëm duhet me u pajtuar këshilli i prindërve.

Egzona Terdevci, faleminderit zotëri Lladrovci, faleminderit drejtor, nuk është problemi të emri nuk e kemi probleme të emri unë as nuk e njoh as nuk e njohin koleget e mija, problemi është konflikt interesi që dikush që është ushtrues detyrë i drejtorit të shkollës me qenë pjese e procesit me i zgjedhe drejtoret tjerë, kaq punë besoj duhet me e ditë edhe ju.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, e nderuar me rregullore është e përcaktuar këshilltari i këshillit të prindërve d.m.th prej këshillit të prindërve që të jete anëtarë i komisionit dhe deri sa ai e mban atë pozite nuk është konflikt dhe nuk specifikohet që nuk do të jetë drejtor. Ai është ushtrues detyrë dhe sigurisht që ne kemi filluar procedurat komplet në të gjitha shkollat për zgjedhjen e anëtarëve të ri nëse ka ndryshime të këshilli i prindërve por edhe në nivel komunal.

Egzona Terdevci, po e kuptoj rregulloren por prapë nuk është në rregull, që për ushtrueses të drejtorit të shkollës me kanë pjesë e procesit të zgjedhjeve të drejtorëve të ri të shkollave, ju mundeni me kërkuar kohë shtesë me propozuar prej këshillit të prindërve dikën tjetër ama nuk ka logjike për besë nëse miratohet ky vendim duhet me ankimi në MAPL, se është e jashtëligjshme.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, ai është ushtrues detyrë i drejtorit dhe është kryetar i këshillit të prindërve edhe kjo ndërrohet nëse ai bëhet drejtor me mandat këshilli i prindërve e bënë dikën tjetër kryetar dhe zgjidhet ndërrohet emri pa problem, thash nëse e keni një emër të këshillit të prindërve që doni me e propozuar e keni edhe këtë mundësi edhe pse është e drejte e imja me e përcaktuar. Në fakt për zgjedhjen e drejtorëve do duhej të ishte edhe një drejtor shkollë sepse niveli i drejtorëve në komision të paktën duhet në komision në nivel të përzgjedhjes së personit ose anëtarit, drejtorit që zgjidhet me qenë i atij niveli, asnjëherë në nivele me të ulëta nuk munden me kanë komision nëse nuk e kanë nivelin për zgjedhjen e drejtorit

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, do të thotë gjatë propozimit është marre parasysh edhe ky fakt që duhet të jetë niveli i përgatitjes, personi në fjale është me master, për ata ne kemi shkuar

me propozim për shkak që kërkohet edhe me rregullore që të jetë në nivelin, mos të jetë në nivelin e përgatitjes profesionale të kandidatit potencial që munde të përzgjidhet për drejtor.

Egzona Terdevci, faleminderit shumë për mundësinë, drejtor Kryetar të gjithë ju që jeni përgjegjës për këtë çështje, a bënë me e lanë këtë pike të fundit sot me u dhënë kohe këshillit të prindërve me e zgjedhe një përfaqësues tjetër e mos të e shkelim ligjin. Nuk besoj që nuk ka brenda këshillit të prindërve persona të tjerë të përgatitur me nivel të masterit.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, nuk mundemi me e bërë as ndryshim të pikës së rendit me e lënë në fund as me e kaluar këtë pike, është votim me votim me shumice në nëse i ke bindur këta me shumicë të votave e votojnë kundër dhe kalon në muajin tjetër vjen. Ne nuk mundemi me e thirrur këshillin e prindërve me u takuar mbase një ore deri të përfundojmë në së shumica janë në punë nuk mundemi me e shty e votoni e dërgon për ligjshmërinë, nëse na kemi gabuar që është e mundshme që kemi gabuar, e kthen Ministria në mbledhjen tjetër e ndryshojmë. Unë të thashë ma jep një emër unë po ta pranoj nuk e kam atë problem sepse e drejte e imja është me e propozuar dikën prej këshillit të prindërve.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, arsyeja pse e kemi propozuar këtë muaj dhe nuk kemi pritur derisa të përfundohen procedurat e përzgjedhjes së kryetarit të këshillit të prindërve, kryetarit të ri të këshillit të prindërve sepse në janar, ju skadon afati dy drejtoreshë dhe ne do të vazhdojmë nesër ose maksimum javën tjetër me hapjen e konkursit, për përzgjedhjen të drejtoreshë.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, duhet me kohe me i bërë propozimet. Thuaje këshilli i prindërve nuk ka pasur kohe prej shtatorit, me u mbledhur ose ka pasur kohe me u mbledhur për me e zgjedh një këshill të ri është temë tjetër, por tash po e bien këtë pike po i bien që unë po e kuptoj ashtu sikur së je para një akti të kryer duhet me e bërë komisionin se nuk bënë. Unë mundem me shty me ushtrues detyre edhe tre muaj tjerë nëse është nevoja dhe i zgjidhni kur të është ne rregull komisioni, po nëse i ka plotësuar kriteret i plotëson kushtet edhe Ministria beson së ne nuk e dimë, nëse Ministria beson që nuk na kthen ligjshmërinë e këtij akti këtij vendimi me na e kthye na vazhdojmë me e anuluar atë vendim dhe me e bërë vendimin e ri.

Arbër Halilaj, faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit e kam për sqarim para vetës rregulloren dhe po e shoh që neni.14 përbërja e komisionit, pika tetë (8) pike një(1) dy, anëtarë të Komunës të cilët propozohen nga DKA-ja dhe miratohen nga Kuvendi Komunal, anëtari i parë është i punësuar në DKA, d.m.th jemi në rregull të kjo pikë, edhe është me nivel të shkollimit të baras vlefshëm më përzgjedhjen e drejtoreshë mirëpo të pjesa tjetër thotë anëtari i dytë i propozuar nga DKA mund të jetë ekspert i pavarur i arsimit drejtor i institucioni arsimor me performancë të lartë, përfaqësues nga këshilli i prindërve d.m.th janë dy tri opsione nëse në këtë rast është ushtrues detyrë mund të propozojmë një që është drejtor, është pika 12 kjo nuk e di qysh dëshkohet kjo thotë asnjëri nga anëtarët e komisionit përzgjedhës nuk mund të janë personat që janë të angazhuar politikisht, apo që kanë pozitë udhëheqëse partiake .

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, do të thotë kjo është ajo pikërisht që ne mendojmë që jemi në rregull sa i përket propozimit .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën 3. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.

Për votuan 19, Abstenim 0, Kundër 8

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Draft Propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029.

Egzon Terdevci-unë i kam disa pika që po dua me i diskutuar të Draft propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029, së pari mu është dukur e paarsyeshme që janë paguar 8 mijë 890 euro për me përgatit këtë strategjia që është shumë e dobët edhe nuk ka parametra të matshëm dhe me gabime teknike siç është në faqen 17 që i keni 11 drejtori ku e dim që Drenasi ka 12 drejtori, në faqen 56 njëra prej objektivave është dhënia në shfrytëzim e pronave komunale me qëllim krimin të infrastrukturës, për vitin 2025, janë parapare 100 mijë euro kosto, nuk po e kuptoj pse duhet me pasur kosto për me i dhënë pronat në shfrytëzim, pse duhet me qenë njëqind mijë euro kostoja për me i dhënë pronat në shfrytëzim. Pjesa tjetër është të faqja 60, është hartimi i projektit ideor për nxemje qendrorë në qytet 2026-2027, janë të parapamë 150 mijë euro, a ka të beje me atë propozimin që e keni pasur me herët me Feronikelin, a është një propozim tjetër dhe u përmend disa here në strategji sistemi i ujitjes për bujqit.

Nga informacionet që i kemi Komuna e Drenasit është një nga komunat e vetme që nuk ka memorandum bashkëpunimi me “Iber Lepencin”, pse ka ndodhur kjo dhe a jeni penduar që nuk keni bërë bashkëpunim të tillë që në strategji janë parapare 22 mijë euro, për periudhën 2025-2027, për këtë çështje këtë e keni të faqja 77, si dhe kostoja totale për të gjitha aktivitetet e parapara për zhvillim ekonomik të Drenasit, është 56 milion, është kosto e larte por megjithatë parametrat objektivat, nuk të qojnë aspak në zhvillim ekonomik të Drenasit.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, çështjet teknike 11,12 janë gabime teknike janë njerëzore dhe rregullohen, na nuk kemi bërë asnjë shkelje ligjore mundesh me e dërguar në prokurori edhe me të kthyer prokuroria përgjigjën.

Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik Agnesa Bucolli, faleminderit kryesues, e nderuar siç e ceku edhe Kryetari, ne i kemi pasur të parapamë mjetet për me e paguar kompaninë në fjalë ajo ka qenë me procedura të rregullta, ndërsa për ato gabime kanë qenë gabime teknike ne edhe njëherë e shikojmë dhe e dërgojmë në MAPL, për miratim gjithashtu ka qenë në konsultim publik, kemi mbajtur edhe konsultimin me qytetar nuk keni marr pjesë, këto tjerat mundën me u përgjigjur edhe drejtorët për te cilët kanë pyetjet, kështu që gjithçka jemi në rregull vetëm e presim ligjshmërinë deri sa të kthehet pas votimit.

Egzona Terdevci, faleminderit kryesues, në faqen 56 venja në shfrytëzim e pronave komunale, krijimi i infrastrukturës për vitin 2025, 100 mijë euro, unë s’po kuptoj pse duhet me pasur kosto 100 mijë euro, me i dhënë pronat në shfrytëzim.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, ne jemi në zhvillim e sipër të procedurave të” Parkut të Biznseit”, “Parku Drenasi 2”, jemi bashke financues ata financojnë disa gjera neve na kanë kërkuar për dijeni tendë edhe projektin me e bërë, na ka kërkuar Ministria edhe projektin

e Fabrikës të përpunimit të ujërave të zeza, mundesh me ju dërguar një mesazh atyre dhe me ta kthyer përgjigjën menjëherë dhe këto janë mjete të parapamë. Nuk është tema për dhënien e pronave jashtë “Parkut të Biznesit”, sepse na nuk kemi nevojë me nda mjete për me i dhënë pronat që i kemi ane e kënde Komunës tonë, është fjale për “Parkun e Biznesit Drenasit 2”, infrastruktura, ujësjellësi, kanalizimi, rrjeti elektrik, telefonia, asfaltimi, parcializimi, krejt janë që i kemi me ministrin, nëse i duhen ministrisë i kemi ne dispozicion nëse nuk i duhen mjetet mbesin aty.

Egzona Terdevci –keni mundur me precizuar tamam për çka duhet jo me bërë një përshkrim të tillë i kam edhe dy pyetje të tjera njëra për nxemjë qendrorë, a është plani i njëjtë si ka qenë me herët me Feronikel, edhe pyetja tjetër për sistemin e ujitjes komuna e jonë nuk ka memorandum bashkë punimi me Iber Lepencin e i keni para pare 22mijë euro për këtë çështje vitin 2025

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci- fizibilitetin e ka përfunduar ministria e ekonomisë ato i kemi para parë ne me i pas ne proces në çoftë se mundemi me gjet donator në qoftë se qeveria na jep parë shtesë në bashkë financim d.m.th nuk ka të bëjë me ngrohje nga Feronikeli sepse nuk i plotëson kriteret për ngrohje.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën 4.Draft Propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029.

Për votuan 19, Abstenim 3, Kundër 5

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 5.Raporti Financiar Janar- Shtator 2024.

Egzona Terdevci-të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale në raportin financiar janë zero a ka pas pagesa në këtë kohë ose pse nuk janë bërë pagesat, është një zë kontabël shitja e pasurisë publike është një vlerë 15 mijë e 119euro 2024, a mundemi me ditë se qa është shitë. Në Buxhetin për vitin 2024 kanë qenë të parapara 493 mije euro subvencione a mundemi me ditë sa nga këto sa i ka në dispozicion komuna e Drenasit edhe po e shoh të subvencionet në drejtorin për kulturë rini e sport 4477 mijë euro për çka janë shpenzuar këto pasi që subvencionet janë anuluar , pse nuk i paraqitni asnjëherë në raportin financiar borxhet që i ka komuna se janë të lidhura me raportin financiar unë po i adresoj nëse nuk marr përgjigjeje i bëj me shkrim, pse nuk paraqiten ne raport borxhet e komunë e as llogaritë e argetueshme, edhe a ka ndonjë mjet financiar që komuna mundet me ri orientuar për subvencionet edhe pyetjet që lidhet me raportin financiar kur janë marrë mjetet prej kontratave kolektive që ka ardhë deri të anulimi i subvencione për kulturë rini dhe sport .

Drejtoresha e financave Albulena Saliuki –përshëndetje për të gjithë është përpiluar në bazë të dispozitave ligjore dhe i keni të dhënat mbi investimet kapitale sa i përket performancës e të hyrave në këtë nëntë mujor kemi tejkallim të planifikimit të të hyrave për 4.82% sa i përket gjobave të gjykatave dhe komunikacionit në periudhën kur kemi raportuar nuk e kemi pasur raportin ,mirëpo tani veç se i kemi pranuar nuk është bërë ende alokimi i tyre .

Egzona Terdevci –faleminderit shumë drejtoresh po ti realisht veç e prezantove raportin që ne e kem po unë e ngrita disa pyetjeje nëse donë mundem me i përsërit prapë pyetjet e mija nëse nuk

e keni pas vëmendjen. Pyetje e ime është pse janë zero të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale tek raporti financiar a nuk janë arkëtuar pagesa në këtë kohë, pse janë zero të hyra nga shfrytëzimi i pronës komunale kur e dim se komuna i ka disa prona në shfrytëzim, është një zë kontabël shitja e pasurisë publike që është në vlerë 15 mijë e 119.21 euro çka është shitë prej pasurisë publike me buxhetin e vitit të kaluar kanë qenë të planifikume 493 mijë euro subvencione sa nga këto mjete i ka aktualisht në dispozicion Komuna e Drenasit dhe për çka janë shpenzuar 104 mijë e 777euro tek subvencionet përkatësisht të DKRS-ja, a janë marr këto mjete nga thesarit apo janë shpenzuar për diçka tjetër.

Edhe një pyetje kur është miratuar buxheti për vitin 2024, subvencione të planifikuara kane qene 493 mijë euro, po pyes sa nga këto mjete i ka aktualisht në dispozicion Komuna e Drenasit, tek shpenzimi për këtë nëntë mujor te subvencionet për DKRS-së, janë 104 mijë e 777euro, për çka janë shfrytëzuar këto mjete e kam pare qe janë anuluar subvencionet për Drejtorin e Kulturës Rinise dhe Sportit. A mundem me e dite se kur janë tërhequr mjetet nga thesari se ky proces ka përfunduar me 11 tetor, pra me 4 tetor është shpallur thirrja publike për fituesit e subvencioneve, në kulturë, rini dhe sport dhe kane qenë edhe shtate dite për me i plotësuar dokumentet teknike.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci - a je duke folur për Raport Financiar janar-dhjetor, nëse je duke folur për janar dhjetor, po thua që ne nuk e kemi bërë njoftimin që janë anuluar subvencionet, për shkak se na i ka marr përmbaruesi dy dite para se me shpall listën e përfituesve. Unë nuk mundem me ditë datën edhe ditën, ne nuk e bëjmë raportin vet ne i marrim te hyrat nga sistemi qe e bënë Qeveria e Kosovës, se nuk kemi te drejte dhe s'mundemi me e bërë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, mbase pika e pestë nuk votohet vazhdojmë me piken e gjashtë të rendit të ditës.

Raport për implementimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin Fiskal 2023.

Egzona Terdevci, faleminderit kryesues unë e kam një pyetje për gjetjen A3, monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes e prokurimit, është përmendur si sfide nga ana e Komunës, mungesa e njohurive për menaxheret e projekteve, mungesa e njohurive për platformën e prokurimit, a keni menduar ndonjë zgjidhje me ju mbajtur menaxhereve të projekteve apo diçka që ju mundëson atyre me e pasur të njohur platformën e prokurimit.

Kamer Rama, raportit progresit bëhet për implementimin e rekomandimeve të dhëna për vitin e kaluar, për vitin 2023 i kemi pasur gjithsej pesë rekomandime prej auditorit të përgjithshëm. Për këtë pikë e keni të shënuar edhe në raport aktivitetet të cilat janë ndërmarr për secilin rekomandim që e ka dhënë zyra e auditorit të përgjithshëm, për trajnim të menaxherëve ne i kemi menduar megjithatë asnjëherë nuk munde te arrihet trajnimi i plote për arsye së menaxher të kontratave nuk i kemi vetëm shërbyesit të cilët janë punëtor të Komunës, por menaxher të kontratave shpesh herë ndodhë të jenë edhe punëtor të arsimit, për sferën e arsimit punëtorë të shëndetësisë për sferën e shëndetësisë, por mundet me ndodhe edhe administratoret e fshatrave, për disa projekte nëpër fshatra kështu që një trajnim i plotë i menaxhereve nuk munde të bëhet.

Na kërkesat për trajnimin e punëtorëve çdo herë i bëjmë me planin për trajnimin e stafit në kuadër të Kuvendit Komunal, për momentin tash jemi në përgatitjen e planit të trajnimit për punëtorët e Komunës gjatë vitit 2025.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, mbase pika gjashtë nuk votohet, vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës.

Propozim - vendim për Plotësim-ndryshimin e vendimit nr. 02-400/01-45467 të dt. 13.09.2024 për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, dua të bëjë vetëm një sqarim propozim-vendimin e kemi bërë vetëm për arsye sepse, MAPL-ja nuk na kanë kthyer akoma përgjigjejen e aktit të Komunës, që është bërë me 19 shtatore, për dijenin e të gjithëve mos kthim i përgjigjes është i qëllimshëm sepse sot është dita e fundit që ne mundemi me bërë zotime për investime kapitale. Ministria ka pasur komunikim të vazhdueshëm nga zyra e Kuvendit me kërkesa me na kthyer përgjigjen disa herë por nuk na kanë kthyer

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën 7. Propozim vendim për Plotësim-ndryshimin e vendimit nr. 02-400/01-45467 të dt. 13.09.2024 për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.

Për votuan 26 , Abstenim 0 , Kundër 0

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 8. Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 12/030-65509 i dt. 23.12.2021.

Florentina Elezi unë po e tërhjeki dorëheqjen time për me qenë pjesë e komitetit për politik dhe financa kështu që vazhdoj me kanë pjesë e komitetit.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, d.m.th po e tërë hiqni pikën e rendit të ditës deklarohu .

Florentina Elezi - po e tërhjeki dorëheqjen time.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani-atëherë grupi i VV-së po e tërheqë propozim vendimin për pikën shtesë të rendit të ditës.

Mehdin Salihu-pasi u tërheqë pika nuk po vazhdoj edhe pse e pashë këtu në letër që na keni sjell që vërejtja e jonë edhe propozimi jonë nuk u merr parasysh fare.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci- Florentina e ka sjell kërkesën për dorëheqje nga komiteti edhe kërkon me zëvendësuar me një anëtar tjetër, ju e keni anëtarin e juaj të regjistruar në KQZ që si subjekt ju takon, që është Hamit Haxhiu në çiftë se ky jep dorëheqje ose nëse ju kërkon me e shkarkuar ne e qesim në vota dhe me vota kalon sepse KQZ-ja e përcakton numrin e të gjithë atyre që janë të regjistruar si fitues të subjektit të caktuar dhe ju keni mundur me parë edhe në mbledhjen e jashtëzakonshme katër ose pesë janë nënshkruar mbi bazën e subjektit ku kanë qenë si rezultati i certifikimit nga KQZ-ja .

Mehdin Salihu-unë kërkoj nga profesori Hamit me dhënë dorëheqje së nuk e përfaqëson më subjektin tonë politik, nëse e ka vetëm për një pagë jemi në gjendje me ja kompensuar atë pagë.

Hamit Haxhiu-në mbledhjet e me hershme kam dashur me jep dorëheqje prej komitetit për politike dhe financa po ju paraprakisht i ngut edhe shtitë si rend ditë, kështu që bëni votat edhe kjo nuk ka nevojë me u kthyer vetëm bëni votat.

Mehdin Salihu- mu nuk me pengon subjekti politik i Hamitit, por moralisht ,ligjërisht dhe në çfarë duash formë ky nuk përfaqëson DD në komitet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, i nderuar a po tërhiqeni a po vazhdoni ?

Mehdin Salihu- edhe ne po tërhiqemi por kërkoj prej profës me reflektuar.

Beqir Kiqina –të nderuar nëse ju kujtohet unë kam qenë anëtar i vetëm që kam votuar kundër, në mënyrë që nuk janë përfaqësuar të gjitha ngjyrimet politike sikurse ka ndodhë në mandatin e kaluar ku subjekti fitues i ka marr dy përfaqësues, subjekti i dytë dhe këto tjerat të gjithat e kanë marr nga një dhe opozita është koordinuar mes, ju atëherë si DD na keni përjashtuar neve si AAK dhe LDK-në, dhe e kemi votuar kundër sepse nuk keni reflektuar bashkëpunim për me u ndarë në mënyre proporcionalë, kështu që edhe tani votoj kundër.

Milaim Hajdari –realisht ligji për zgjedhjet e përcakton shumë qartë, për me u zëvendësuar një anëtar i kuvendit duhet me shkuar kërkesa prej grupit me pajtimin e atij që e lëshon komitetin për politike e financa, përndryshe të gjithë anëtarët e komitetit për politike e financa konsiderohen me mandat katër vjeçar sikurse anëtarët e kuvendit, në rastin e propozimit të VV-së është e drejt d.m.th., nëse ajo ka pranuar vete e bënë deklaratën e dorëheqjes dhe në bazë të deklaratës se saj sekretariati ose departamenti për çështje ligjore ne KQZ vendos në favor se e ka obligim, në rastin e propozimit tjetër që po debatohet këtu prej Mehditit konsideroj që përjashtimisht qysh votojmë ne departamenti për çështje ligjore e kthen negativ sepse konsideron që një anëtar i kuvendit që është pjesë e KPF-së e ka mandatin katër vjeçar është e pa nevojshme me krijuar situata të tilla.

Labinot Halilaj- është mirë me votuar për tërheqjen e pikës të rendit të ditës që propozues ka qenë VV edhe VV është ajo që po tërhiqet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, me kërkesën e lëvizjes vetëvendosje tërhiqet pika e rendit të ditës.

Për votuan 24, Abstenim 1, Kundër 0

Kryesuesi i Kuvendit Komunal **Bekim Lestrani**, hapi për diskutim pikën e 9.Propozim Vendim për plotësim/ndryshimin e Komitetit për Komunitete nr.12-030/01-65508 i dt.23.12.2021 i plotësuar me vendimin nr.02-030/01-14938 të dt.28.03.2023

Egzona Terdevci- propozoi qe anëtar i jonë Drin Halilaj të zëvendësohet me Egzona Terdevcin

Kryesuesi i Kuvendit Komunal **Bekim Lestrani**- **hodhi në votim pikën** 9.Propozim Vendim për plotësim/ndryshimin e Komitetit për Komunitete nr.12-030/01-65508 i dt.23.12.2021 i plotësuar me vendimin nr.02-030/01-14938 të dt.28.03.2023

Për votuan 21, Abstenim 1, Kundër 3

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 10. Vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit nr.02-020/04-14930 i dt.28.03.2023

Florentina Elezi- në vend të Drin Halilaj propozojmë Egzona Terdevci.

Beqir Kiqina- sa i përket këtij komisioni e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave etj kisha kërkuar nga ky komision me qenë me fleksibil në raport me kërkesat të cilat janë deponuar me vite e muaj, sepse ka shumë ankesa nga qytetarët .

Egzon Terdevci – nuk po e kuptoi pa qartësinë të cila po shkelet barazia gjinore se jam duke e parë komisioni për komunitete dhe kthim janë tri vajza me mua bëhen katër, nëse shkelet barazia gjinore atëherë nëse është shkelje ne nuk kemi propozim për tjetër te gjinisë mashkullore .

Hamit Haxhiu -unë për këtë komision propozoi Selam Qallapekun

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e 10. Vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit nr.02-020/04-14930 i dt.28.03.2023, me propozimin e ri Selam Qallapekun.

Për votuan 24, Abstenim 1, Kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani –hapi për diskutim pikën 11. Të ndryshme. **Albulena Saliuku**- kur jemi të kodit 50-405, tek shfrytëzimi i pronës Komunale vetëm deshta ta konfirmoj që është bërë një ndërrim i kodit nuk është 0 mirëpo bëhet fjalë për qiraja nga vendosja e objekteve tregtare ndërrimi i kodit në 50-407 në total është 35-622 ndërkaq sa i përket kodit 50-413, shitja e pasurisë publike, sistemi në mënyrë automatike i gjeneron të dhënat dhe këto të hyra figurojnë të ky kod vlen për Drejtorin e Urbanizmit.

Drejtori i Urbanizmit Petrit Gashi- e kemi pas disa herë debat tek ndërrimi i kodeve sidomos të sektori ekonomik drejtoria e zhvillimit ekonomik të bizneset po edhe tek ne, tani janë kode të veçanta të cilat d.m.th inkasohen ato mjete dhe në këtë rast ne nuk kemi qasje vetëm ministrit e linjës kanë qasje që bëhet arkëtimi i këtyre mjeteve kanë shkuar me një kod të veçante janë faturat të cilat janë paguar për ndërrim të destinimit të tokës nuk bëhet fjalë për tokë publike por për tokë private, po me gjithë atë çka do që ju intereson mundemi edhe me nxjerr edhe raport të gjitha faturave të paguara.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci- siç edhe e kemi njoftuar KPF-në, jam i obliguar me sjellë një listë të gjithë atyre që janë të interesuar me marrë pronën tonë në shfrytëzim ne negocim nga 1 deri 99 vite ju e keni para vetës një listë, të investitorëve të interesuar për me marrë pronë në shfrytëzim, unë kisha kërkuar nga një anëtarë prej secilit grup me formuar komision me i takuar me negociuar me i sjell këtu me bërë dëgjime publike edhe

prapë ju e keni në dore me ja dhënë ose mos me ja dhënë në shfrytëzim investitorit por unë ju ftoj me i dhënë dritën e gjelbër në të mirë të qytetarëve të Drenasit .

Egzona Terdevci- ne këtë listë e kemi pranuar shumë vonë edhe nuk kemi mundur me e kuptuar detajisht a bënë me na përcjell neve edhe ofertat ose planetë e bizneseve që ja kanë dërguar këto kompani sepse vetëm kështu nuk mundemi me i vlerësuar edhe a po mendon me i dhënë pronat veç me negociim apo kanë me qenë me ankand të hapur .

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci-ofertat i keni para jush planet i bëjnë kur fillojnë me procedurat e negociimit .

Hamit Haxhiu –paraprakisht unë kam qenë anëtar i komisionit edhe në dy ofertat e me hershme që kanë qenë këtu të ne ,në bazë të kësaj listës qe po e shohë d.m.th është një interesim i jashtëzakonshëm ,unë jam për me e formuar një komision për negociim edhe me diskutuar se është një oferte shumë e mirë.

Florentina Elezi – në këtë fazë qe jemi ende nuk ja kemi jep dritën e gjelbër këtyre kërkesave që veç janë bërë a ka kohe në qoftë se një qytetar a biznes po na dëgjon dhe për të njëjtën toke për njëërën prej këtyre me e sjell një kërkesë ndoshta me të favorshme deri kur ka kohe për me e bërë një kërkesë të tillë .

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci-kohë ka gjithmonë po për të njëjtën pronë nuk e di, po mund të debatohet gjatë dëgjimeve publike ne mund të ia japim edhe atij mundësin , po kur dihen çmimet është me problem se dikush mundet me ardhë me e vendose një euro me shumë edhe me na bërë telashe. Përcaktohuni në mbledhjen tjetër mund ti propozojmë anëtarët duhet me funksionu shpejt sepse, ne prona mundemi me dhanë vetëm deri në prill gjashtë muaj para zgjedhjeve të reja.

Egzona Terdevci-po pajtohem me e shtyrë propozimin sepse ne nuk kemi ende një vendim nga MPL-ja për ligjshmerin e vendimit të datës 19.09.2024 nuk është kthyer ende vendimi për ligjshmëri pra mundet me pas ndryshim te pronat që kanë kaluar, edhe duhet që ne si asamblist aq sa keni materiale ju duhet me pasë edhe na nëse duam me kanë pjesë e një komisioni të tillë negociues besoi që është e drejt që të njëjtat informatat që i keni ju me i pas edhe na neve këtu na keni sjell vetëm një listë me kërkesa .

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci-pajtohem me juve me e pasë materialin ata që na dorëzohet neve, ata vetëm shfaqin interes me proceduara të përgjithshëm, pastaj kënd ju ta vlerësoni ne e thërrasim edhe i japim afat dy javë ditë me ardh me e bërë dëgjimin publik në kuvend dhe me diskutuar a me vazhduar me tutje .

Azemin Gjoka –pershendetje për të gjithë sot përsëri para jush po e ngris zërin për dy çështje që kanë mbetur pezull për shume kohe :1 çështja e ujit të pijes për lagjen Gjoka në Terstsenik pasi që është vetëm një kilometër gjatësi për me i furnizuar me ujë të gjithë banoret e asaj lagje kjo nuk është hera e parë që po e ngre këtë çështje dhe fatkeqësisht siç duket jemi ende ne të njëjtin vend pa ndonjë zgjidhje konkrete për me shumë ë se dy dekada banoret e kësaj lagjeje jetojnë pa qasje në ujë të sigurt dhe të pastër çdo here që jemi mbledhur këtu kemi dëgjuar vetëm premtime por ato nuk u përkthyen në veprime ,ndërkohë banorët e kësaj lagjeje përballen me vështirësi të

mëdha për shëndetin ,mirëqenien dhe për ekonomitë e tyre ,ne kërkojmë që kjo çështje të trajtohet një here e mirë si përparësi nuk po kërkojmë asgjë me shumë se sa një plan konkret dhe afate të qarta në përfundimin e projektit të ujësjellësit për lagjen tonë ,unë ju ftoi të mendoni për përkushtimin tuaj ndaj qytetareve që ju zgjodhën se mungesa e ujit të pijshëm është një çështje e të drejtave bazike dhe një detyrim i Komunës ndaj qytetareve të saj për të ju ofruar zgjidhje pra pyetja për juve është :Kur do te kemi ujë për pije ne lagjen Gjoka ?

Çështja e dytë është ajo e ujërave të zeza që po derdhen direkt në lum nga banoret e lagjes Bylykbashi dhe Cakiqi dhe në mënyrë indirekte në te vetmin burim ku ne furnizohemi me ujin që e përdorim për amvisëri, ky problem jo vetëm që po e ndotë mjedisin po urgjentisht duhet të marrim masa për rrezikun shëndetësor për banoret e kësaj lagjeje.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci-do ta regjistrojmë këtë qe e keni kërkuar ju japim përgjigjeje në mbledhjen e ardhshme .

Mehdin Salihu-kam dy pyetje për zotin Gruda, kam një ankesë të qytetarëve që banojnë aty të parkingu të citi grill, të cilët i kanë kryer pagesat dhe nuk mundën me e shfrytëzuar parkingun d.m.th nuk janë vendos laura, pyetje e dytë e di që jeni mbrapa me ndriçimin publik, lagjen Selmani, Bilali dhe Halilaj, në fshatin Shtuticë, kanë telashe të mëdha sepse me kthimin e orës nxënësit kthehen vonë nëpër shtëpi edhe kanë vështirësi me u kthyer.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci-parkingun kanë të drejt me shfrytëzuar të gjithë qytetaret e Drenasit pa dallim pa pagesë jo atë, po mbi 500 parkingje të Komunës tonë, sa i përket ndriçimit në proces jemi, t'i ke shqetësime ne kemi edhe me shumë së t'i me ia bërë sigurin fëmijeve qytetareve por ne nuk mund ti shkelim procedurat me mbajte përgjegjësi .

Mehdin Salihu- çështja është se njerëzit kanë parapaguar me e shfrytëzuar atë parking 3-4 muaj,6 muaj ka edhe për një vite qe e kane bërë parapagese i kane faktuarat çka do të ndodh me ata njerëz a do të behët kompensimi i parave te tyre.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci- ata që e kanë parapaguar janë duke e shfrytëzuar parkingun, po them se e kemi rregulluar dhe janë parkingje të jashtëzakonshëm për të gjithë qytetaret e Drenasit.

Florentina Elezi – unë kam një pyetje për drejtorin e Drejtorin e arsimit në shkollën fillor “Dëshmorët e Drenicës”, ne Çikëtove të vjetër nxënësit e klasës së shtatë nuk kanë mësimdhënës të matematikës, që nga shtatori dhe ende nuk është hapur ndonjë konkurse dhe a mundemi me e ditë kur do të rregullohet ky problem.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, atëherë përgjigja është së mësimdhënësja që është e angazhuar në Vasilev, do të filloj nga kjo jave vetëm janë duke e përshtatur orarin në shkollën “Dëshmorët e Drenicës”,kështu që ajo i ka 16 ore në Vasilev do të plotësohet me 4 ore shtesë por janë në procedure është zëvendësuar me koordinator të cilësisë, orët e matematikes do të zëvendësohen me orë shtesë nga mësimdhënësja që është caktuar të i mbaj ato orë .

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, nuk ka rëndësi a zëvendësohen me koordinator apo me mësimdhënës, por me ditur me ju shpjeguar sipas planit dhe programit që e kanë pasur, na jemi duke e zvogëluar numrin ne nuk mundemi me larguar dikën që ka vendim të

përhershëm dhe ato profesione ka me i zëvendësuar atë ku është e mundur që mësimdhënësi me kanë i përgatitur me e dhënë edhe një lëmi tjetër nëse nuk gabo.

Florentina Elezi -Kordinatoriori është me profil të historisë e jep matematik edhe përveç kësaj kanë zëvendësuar menjëherë në shtator po tash ka fundi i tetorit d.m.th nxënësit po humbin .

Egzona Terdevci- unë i kam tri çështje kushdo mundet me u përgjigj, po fillojmë me Çikatoven e vjetër që janë vendos shkëndijat për satcion të autobusëve direkt në rrugë, unë nuk ke di nëse ka pronë publike në çikëtove të vjetër , çështje tjetër është konkursi për koordinator të cilësisë ju e keni emëruar dikën në tetor nëse nuk gabo të vitit 2022 vendim i cili ju ka kthyer prej gjykatës për shkak së personi ka qenë me shkollim të mesëm të mjekësisë dhe jo siç kërkohet nga qarkorja ,statuti rregullorja dhe ligji për zyrtarë publik vendimi i gjykatës është në maj të vitit 2024, në shtator e keni shpall konkursin po çuditërisht është zgjedh i njëjti person vetëm që tash e keni legjitimitet me konkurs. Pse nuk e keni zgjedh dikon siç kërkohet nga ligji për zyrtarë publik, nga rregulloret? por e keni dërgua dikon me shkollë të mesme. Dhe çështja tjetër është furnizim i me dru dhe lënde djegëse për institucionet e komunës së Drenasit e kam përcjell këtë tender vlere e tenderit e kalon zotimin që e ka komuna e Drenasit ka marr dru me çmime statusferike çmimi i drurit është 95 euro, kurse çmimi i tregut është 50,55,60 euro po nuk është problemi vetëm të çmimi po është edhe matja e druve behët në kamion që dihet që ka mundësi shumë për manipulime të sasisë edhe vjedhjeve, çmimi i peletit është 380 për ton unë personalisht i kom dërguar kompanive kërkesë për ofertë me të njëjtat karakteristika dhe besomëni që 220,225 është çmimi qysh po mundeni me i gjete kështu këto çmime kaq të shtrenjta me dëmtuar kaq shume buxhetin e Drenasit.

Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci-kushdo që aplikon brenda institucionit i plotëson kriteret edhe e merr atë pozitë që e ka marr personi në fjalë , ne kemi tenderë te hapur publik nuk e kemi bërë me negociim tu kisha lutur që ato kompani që të kanë ofruar çmime të ulta ti sjellni për vitin tjetër

Nexhmedin Gruda-e regjistrua pyetjen dalim e verifikojmë e bëjmë një vlerësim është fat që drejtorja jonë e ka inxhinierin e komunikacionit nuk e besoi që është bërë ai lëshim e shikojmë dhe marrim masa .


Mbledhja përfundoi në ora 13:18

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 31.10.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube <https://fb.ëatch/vT0-u9Aa6G/>

Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-54712 dt. 13/11/2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 34 dhe 34.6 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit për transfer të mjeteve financiare subvencione dhe transfere me Nr.02-400/01-47954 dt. 30.09.2024

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shfuqizimi i vendimit Nr.02-400/01-47954 të datës 30/09/2024, për transfer të mjeteve financiare të kategoris ekonomike Subvencione dhe Transfere në shumën pre 6,825.00 euro.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit Nr.02-400/01-47954 të datës 30/09/2024, bëhet për arsye të mungesës së mjeteve të cilat janë terhequr për kontrata kolektive parase të kthehet ligjshmeria:

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

I'u dërgohet:

- *Zyrës së kryetarit*
- *Zyrës së kuvendit*
- *DBZHR-së*
- *DBF-së*
- *Arkivit*



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-54875 Dt. 13/11/2024

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Neni 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit nxjerr:

PROPOZIM – VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt.19.09.2024

Neni 1

Më këtë propozim-vendim, i propozohet kuvendit të komunës shfuqizimi i vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt.19.09.2024

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt.19.09.2024 behet me rekomandim të Ministrisë, pasi që nuk ka kaluar ligjshmerinë.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimit të ligjshmerisë nga MAPL.

KRYETARI I KOMUNËS
Ramiz Lladrovci